

MENAXHIMI I MIREMBAJTJES

I nderuar Administrator i kompanisë!

I nderuar Drejtues Teknik!

I nderuar Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes!

Nëse jeni duke lexuar këtë prezantim, do te thotë që ju jeni të interesuar të dini diçka më shumë në lidhje me organizimin e procesit të mirëmbajtjes.

Për këtë arsye kemi përgatitur materialin e mëposhtëm.

Çfarë është mirëmbajtja?

“Mirëmbajtja është kombinimi i të gjitha veprimeve teknike dhe administrative, shoqëruar edhe me veprimet e supervizionit, të orientuara të mbajnë ose të risjellin një aset në gjendjen që ai të mund të kryej funksionet e kërkuara”

Ky është përkufizimi i procesit të mirëmbajtjes i cituar nga **Manuali i Mirëmbajtjes Industriale**, një libër që përdoret sot në Universitetet Italiane.

Çfarë është mirëmbajtja?

MIREMBAJTJA

VEPRIMET TEKNIKE



SUPERVIZORI

VEPRIMET ADMINISTRATIVE

Çfarë është mirëmbajtja?

MIREMBAJTJA

Nëse VEPRIMET TEKNIKE nuk kryhen:



Mirëmbajtja ka
rënë,
SUPERVIZORI
nuk ka se çfarë
të shohë

VEPRIMET ADMINISTRATIVE

Çfarë është mirëmbajtja?

VEPRIMET TEKNIKE



MIREMBAJTJA


Mirëmbajtja ka
rënë,
SUPERVIZORI
nuk ka se çfarë
të shohë

**Nëse VEPRIMET
ADMINISTRATIVE nuk kryhen:**

Çfarë është mirëmbajtja?



Pse do të harxhoni
shumë para në
mënyrë joproduktive ?



Për çdonjërin prej këtyre asetëve PRODHUESI ka shkruar dokumenta teknike, ku ndër të tjera tregohen edhe rekomandimet në lidhje me mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre.

Rekomandimet e mirëmbajtjes dhe riparimit duhet të ndiqen në mënyrë rigoroze.

Këtë e dinë të gjithë por në praktikë e zbatojnë shumë pak ose aspak.

Nëse nuk ndiqen rekomandimet e prodhuesit si për mirëmbajtjen ashtu edhe për procedurat e riparimit, atëherë është e sigurtë që kostot do të jenë më të larta.


Po përse do të jenë kostot më të larta?

Sepse për të identifikuar një defekt:

- duhet të dini se si funksionon sistemi operativ
- Elektrik duhet të konsultoheni me skemat elektrike,
- hidraulik duhet të konsultoheni me skemat hidraulike,
- elektronik duhet të konsultoheni me dokumentacionin teknik.

Nëse nuk i bëni këto, do t'ju duhet të harxhoni shumë kohë dhe do t'ju duhet të ndërroni shumë komponentë, deri sa të arrini të gjeni atë të defektuar.

Në këtë rast ju do duhet të paguani si kostot që sjell mundgesa e asetit në punë ashtu edhe paaftësinë e teknikëve tuaj.



Zakonisht ekipi i mirëmbajtjes brenda kompanisë së prodhimit kryen punët që janë më emergjente. Kur punët kryen në emergjencë, kostot janë shumë më të mëdha seç duhet.

Përgjithësisht kompanitë që kanë një numër të konsiderueshëm asetesh kanë Sektorin e tyre të Mirëmbajtjes

Pyetja është:

A i ndjekin sektorët e mirëmbajtjes procedurat korrekte për kryerjen e këtij shërbimi?

Përgjithësisht JO, sepse në vendin tonë mentaliteti është i orientuar drejt riparimit të defekteve dhe jo drejt mirëmbajtjes së programuar

Pra keni humbur para sepse asetin nuk e keni shfrytëzuar në punë, keni humbur para se e keni kryer riparimin me kosto më të lartë seç duhet, keni humbur para se keni vepruar në emergjencë (kostot e pjesëve të këmbimit më të larta, etj)

Në Europë dhe në vendet e tjera të zhvilluara, ky proces është studiuar në detaj. Konkluzionet e këtyre studimeve mund të gjenden lehtë në internet.
Thjeshtë duhet të lexohen dhe të besohen.

Për të mos ju lodhur shumë, po jua përmbledh me dy shprehje.

Në qoftë se aset mirëmbahet sipas programit të rekomanduar nga prodhuesi, kostoja e mirëmbajtjes mund të llogaritet sa 5% e vlerës së blerjes së mjetit (kur ka qenë i ri) në vit

Në qoftë se aset riparohet, atëherë vlera e riparimit llogaritet të shkojë sa 2-fishi i vlerës së mirëmbajtjes.

Ndaj duhet të ndryshoni mentalitet. Nëse nuk e bëni, ju thjeshtë do të vërtetoni atë që kanë arritur në konkluzion të tjerët, duke paguar shumë shumë para.

Duke patur mentalitet RIPARIMIN E ASETIT NE RAST DEFEKTI, si dhe duke ditur që defekti ndodh në një moment të panjohur, përgjithësisht veprimet kryhen në kushtet e emergjencës. Kjo do të thotë që vendimmarrjet do të bëhen nën presion, ndaj dhe produkti nuk do të jetë ai i duhuri. Po jap një shembull:

Supozojmë se mjeti ka një defekt. Nuk ngrihet kollona e vinçit.

Ju do të dërgoni teknikun tuaj më të mirë për të zgjidhur problemin.

Tekniku do të veprojë mbi bazën e njohurive që ka, ndaj dhe do të fillojë të provojë me tentativë kryerjen e disa kontrolleve. Veprimet e mëtejshme të të gjithë kompanisë do të bazohen mbi atë që do të thotë tekniku.

Në qoftë se tekniku e ka gabim, të gjitha veprimet e mëtejshme janë gabim. Padyshim që kanë kosto.

Pastaj ai do të tentoj diçka tjetër. Nëse edhe kjo tentativë është e gabuar, të gjitha veprimet e mëtejshme do të jenë të gabuara.

Tani le ta zemë se tekniku arriti dhe e identifikoi tamam që problemi është një valvol.

Supozojmë se mjeti ka nje defekt dhe ka prishur një valvol.

Ju duhet të blini një valvol të re.

Ku do t'a gjeni?

Fillimisht do të kërkonit në tregun e brendshëm, duke marrë me rradhë të gjithë furnitorët e mundshëm (keni harxhuar goxha kohë dhe karburant).

Nëse nuk gjendet, atëherë jeni të detyruar ta porositni.

Po ku?

Po kostot? (furnitori e sheh që ju e keni emergjente disponimin e valvolës)

Po për sa kohë sigurohet?

Po kostot e transportit? Etj, Etj.

Kostot e riparimit mund të shkojnë aq sa pronarit të asetit i duhet të mendohet NESE JA VLEN APO JO

Po vazhdoj më tej duke bërë supozime të tjera që në fakt janë ngjarje që ndodhin shpesh gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe të riparimit të aseteve.

A është identifikuar në mënyrë të saktë valvola e prishur?

Vetëm kjo është shkaku i defektit apo mund të jetë edhe një komponent tjetër?

A ka shkaktuar defekti i valvolës defekte të tjera?


Kjo valvola prodhohet më apo është model i vjetër?

Nëse hyn tek problemet që dalin kur një aset ka defekt, ato janë të shumta dhe të fillojnë dhimbjet e kokës.

Dhe e gjitha kjo që përshkruam është për një defekt.

Po për të gjitha defektet që ndodhin në asetet e kompanisë?

Asetet janë sigurisht subjekt i defekteve të ndryshme. Edhe nëse mirëmbahen në mënyrë rigoroze, përsëri mund të ndodhin defekte. Por është e sigurtë që nëse mirëmbahen sipas rekomandimeve të prodhuesit, defektet qo të jenë shumë më të pakta.



Nga grafiku majtas tregohet se nëse ju blini një aset shumë cilësor i cili ka besueshmëri të lartë, atëherë kostot e blerjes janë të larta ndërkohë që kostot e funksionimit janë të ulëta. Nga ana tjetër, nëse aset i kushton lirë në blerje, i ka të larta kostot e funksionimit. Nëse vendimmarrja juaj bazohet vetëm tek kostot, atëherë, ju duhet të zgjidhni të blini një aset me besueshmëri mesatare.

Kjo do të thotë që që në fillim është e qartë që aset i do të ketë nevojë për mirëmbajtje dhe riparime gjatë jetës së tij.

Bazuar në të gjitha këto fakte, është mëse e qartë që Ju jeni të detyruar t'i kushtoni vemendjen e duhur impianteve, makinerive apo pajisjeve të punës. Në të kundërt ju do të jeni të detyruar të blini asete të tjera.

Prandaj, Ju keni vetëm 2 mundësi:

1. Të organizoni vetë Sektorin e Mirëmbajtjes, në mënyrën më të mirë të mundshme,
2. Të lidhni kontratë me kompani të specializuara për të kryer mirëmbajtjen.

Në të dy rastet, ju duhet të aprovoni një buxhet të caktuar për mirëmbajtjen.

Në rast se Ju e miratoni një buxhet të tillë, atëherë Objektivi kryesor është që të arrini rezultatin më të madh për t'i patur asetet te disponueshme për punë.

Më poshtë po shtjellojmë opsionin e organizimit të mirëmbajtjes prej EMC shpk.

EMC aktualisht është një ndër kompanitë e organizuara për të ofruar shërbime inxhinjerike dhe shërbime të mirëmbajtjes.

EMC ka filluar aktivitetin e saj ne vitin 2014

Përse këtë lloj aktiviteti?

Sepse ky është një aktivitet shumë i vështirë dhe në Shqipëri nuk ka shumë kompani mirëmbajtje të organizuara mirë.

Ku u bazuam?

Ideja ishte qe ta shnderronim EMC ne një kompani të aftë për të fituar kontrata të mirëmbajtjes me kompani qe disponojnë impiante, makineri dhe pajisje industriale

Te zbatonim praktikat me te mira qe ofrohen sot ne boten e zhvilluar perendimore

Te organizoheshim ne mënyrë të tillë që të kishim performancë maksimale

E zgjodhem mirembajtjen e aseteve industriale sepse ky është një ndër proceset më të vështira, që kërkon njohuri të mëdha, organizim të mirëfilltë dhe impenjim të jashtëzakonshëm

Lexuam dhe i besuam atyre njerëzve që kanë punuar shume në këtë fushë



EMC shpk është e orientuar tërësisht për nga industria dhe ka për qëllim të jetë lider në Shqipëri për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes.

EMC shpk ka sot lidhjet e duhura jo vetëm për të garantuar produktin më cilësor me çmimin më të mirë por edhe për t'i dhënë zgjidhje proçeseve më të vështira të mirëmbajtjes

Ne jemi partner zyrtar të kompanive prestigjioze:

LINDE MATERIAL HANDLING – prodhuese e makinerive dhe pajisjeve të përpunimit të ngarkesave;

HANSA FLEX – prodhuese dhe tregetuese e materialeve hidraulike dhe pneumatike

HOPPECKE – prodhuese e baterive industriale

NILFISK – prodhuese e makinerive dhe pajisjeve pastruese industriale



Aktualisht EMC ka kontrata per mirëmbajtjen e aseteve me kompani te ndryshme, disa prej te cilave janë komplekse.

Nga eksperienca jonë, kemi arritur në konkluzionin që për kompanitë e mëdha, që disponojnë një numër të madh asetesh, opsioni më i mirë është organizimi i mirëmbajtjes brenda vetë kompanisë me tendencën për t'ia kontraktuar më tej këtë shërbim një kompanie tjetër.

Pse?

Sepse nëse Ju jeni kompani prodhuese, vëmendja Juaj është dhe duhet të jetë e përqëndruar tek prodhimi dhe jo tek mirëmbajtja e aseteve.

Sepse nëse jeni kompani ndërtimi, vëmendja Juaj është e përqëndruar tek ndërtimi dhe jo tek mirëmbajtja e mjeteve.

EMC shpk e ka të përqëndruar të gjithë vemendjen vetëm tek mirëmbajtja.

Prandaj, nëse ju dëshironi të jeni partner me EMC shpk, ne Ju asistojmë që ju të organizoni Sektorin Tuaj të mirëmbajtjes, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, praktika të cilat ne i ndjekim çdo ditë në punën tonë.

Pse propozojmë konsulencë mbi organizimin e mirëmbajtjes

Përse sot Ju propozojmë asistencë për organizimin e mirëmbajtjes, kur objektivi i kompanisë tonë është pikërisht përfitimi i kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes?

Sepse edhe në botën e zhvilluar ky proces ka ecur në hapat

MIREMBAJTJE E
PERQENDRUAR



MIREMBAJTJE E
INTEGRUAR



MIREMBAJTJE E
TERCIALIZUAR

Në fakt si mund të pretendojmë në tercializimin e shërbimeve të mirëmbajtjes direkt, kur:

- Impiantet industriale, makineritë dhe pajisjet janë të një shumëllojshmërie të madhe dhe kur eksperiencia jonë e punës nuk është 10-tra vjeçare,
- Burimet njerëzore në vendin tonë janë shumë të kufizuara,
- Kompanitë janë të pozicionuara gjeografikisht në vende të ndryshme, ku dhe mundësitë janë të ndryshme,
- Kompanitë kanë prioritete të ndryshme dhe që zakonisht nuk përputhen me prioritetet e kompanive ofruese të shërbimeve.

Pse propozojmë konsulencë mbi organizimin e mirëmbajtjes

Ne do të jemi të lumtur nëse do të mund t'a fillonim me Ju këtë bashkëpunim pasi përmasat e kompanisë
Tuaj na imponojnë.

Natyrisht EMC shpk nuk do t'a ofrojë këtë disponibilitet me kompani të përmasave modeste apo me
kompanitë që nuk kanë dëshirë të projektojnë zhvillimin

Në Gjermani apo dhe në vendet e tjera të Europës veriore tashmë është bërë praktikë e zakonshme që
kompanitë të fokusohen vetëm tek biznesi kryesor. Shërbimet e tjera ndihmëse të biznesit kryesor shiten tek
kompanitë që për biznes kryesor kanë pikërisht atë shërbim.

EMC shpk ka 5 vite që çdo ditë impenjohet vetëm për proceset e mirëmbajtjes. Ky është biznesi ynë
kryesor.

Po sa të organizuar jemi ne vetë?

Pse sot jemi në gjendje t'Ju asistojmë për të organizuar mirëmbajtjen Tuaj të përqëndruar?

Pse mendojmë se jemi të aftë t'ju asistojmë ?

Aktualisht ne kemi kontrata mirëmbajtje me një numër jo të vogël kompanish.

- Kemi kryer deri më sot 11412 Urdhra Pune,
- Kemi kryer dhe kryejme shërbime të mirëmbajtjes në 835 impiante, makineri dhe pajisje
- Kemi identifikuar dhe kemi kryer procedurë të blerjeve dhe futjes në magazinë për 20988 materiale
- Menaxhojmë një magazinë me 4672 lloje artikujsh
- Operojmë me 98 kompani shqiptare dhe të huaja

Ne mendojmë se jemi të aftë t'ju asistojmë pasi që prej ditës së parë të punës e menaxhojmë kompaninë me anë të një sistemi kompiuterik të ndërtuar pikërisht për MENAXHIMIN E MIREMBAJTJES SE ASETETEVE

Ne mendojmë se jemi të aftë t'ju asistojmë sepse kemi programe trajnimi të detajuara për teknikët e mesëm dhe për teknikët e lartë.

Ne mendojmë se jemi të aftë t'ju asistojmë sepse kemi eksperiencën e duhur.

Bazuar në atë që ju kemi shpjeguar më sipër, ku mirëmbajtja e aseteve mbështetet në dy kollona kryesore:

1. Veprimtarinë teknike,
2. Veprimtarinë administrative (menaxhimi i mirëmbajtjes);

EMC shpk ka punuar për të zhvilluar të dy drejtimet.

- Ne aktualisht menaxhojmë mirëmbajtjen bazuar në një sistem kompiuterik modern,
- Ne kemi krijuar një program të detajuar për trajnimin e teknikëve të mesëm dhe teknikëve të lartë.

Po fillojmë t'ju informojmë fillimisht për programin e menaxhimit pasi sipas mendimit tonë, ai është kuçi i kursimit të parave tuaja dhe i arritjes së performancës më të lartë në punë.

Nëse i kushtoni vëmendjen e duhur këtij materiali, ne jemi të bindur që ju do të gjeni aty zgjidhjen e shumë e shumë problemeve të përditshme.

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes NUK është thjesht një program kompiuterik që mbledh të dhënat. Ai është një krijues i shkëlqyer i një DATA BASE për të gjithë veprimtarinë.

Nga ana tjetër ai është edhe një udhëheqës i procedurave që ju duhet të ndiqni gjatë kryerjes së aktivitetit të mirëmbajtjes.

Rregulli, përqëndrimi i informacionit të grumbulluar çdo ditë, mënyra e kryerjes së procedurave administrative, mundësia e jashtëzakonshme për të bërë analizë etj, janë një kollonat për performancën maksimale në organizimin e punës.

Për t'a shpjeguar më thjeshtë:

- E gjithë kompania flet me një gjuhë, atë të sistemit kompiuterik
- Veprimet që kryhen nga çdo figurë profesionale janë të përcaktuara
- Në çdo rast veprimtaria është e gjurmueshme (e kontrollueshme)
- Informacioni i mbledhur çdo ditë është pronë e kompanisë dhe ngelet aty edhe kur punonjësi largohet.

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes

I kemi detajuar shpjegimet tona për t'ju treguar se ne dimë se për çfarë po flasim dhe se çfarë bëjmë.

Ato që thashë më sipër po jua shpjegoj ndryshe.

Në një kompani me organizim klasik ku nuk disponohet një program menaxhimi kompiuterik

Përgjegësi i mirëmbajtjes



- ka kompiuterin e tij,
- përdor mënyrën e tij për grumbullimin e informacionit (pra ka gjuhën e tij),
- i analizon proceset sipas mënyrës së tij,
- nxjerr raportet sipas mënyrës së vet.

Zyra e blerjeve



- ka kompiuterin e saj,
- përdor mënyrën e saj për grumbullimin e informacionit (pra ka gjuhën e saj),
- i analizon proceset sipas mënyrës së saj,
- nxjerr raportet sipas mënyrës së saj.

Magazinjeri



- ka kompiuterin e tij,
- përdor mënyrën e tij për grumbullimin e informacionit,
- i analizon proceset sipas mënyrës të caktuar
- nxjerr raportet sipas një mënyre të caktuar, në varësi të organizimit të kompanisë.

Tekniku i mirëmbajtjes



- Kryen punët teknike në një mjet,
- evidenton ose jo asetin në të cilin kreu shërbimet sipas gjuhës së tij.
- evidenton ose jo punën e kryer sipas gjuhës së tij,
- evidenton ose jo materialet e perdorura sipas gjuhës së tij

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes


Në përfundim, administratorit që kontrollon veprimtarinë i duhet të shkojë tek çdo figurë profesionale dhe të marrë informacionin që i nevojitet. Mirpo secili prej tyre ka përdorur mënyrën e vet të mbledhjes së informacionit dhe gjuhën e vetë të regjistrimit të informacionit në kompiuterin personal.

Në këtë mënyrë Administratorit do t'i duhet të kuptojë gjuhën e gjithësecilit për të nxjerrë një konkluzion.

Përgjegjësi i mirëmbajtjes

Po kur përgjegjësi është larguar në një punë tjetër apo dhe jashtë vendit?

Në zyrë ju do të gjeni vetëm kompiuterin e tij ku Informacionet ai i ka pas regjistruar sipas mënyrës së tij.



Zëvendësuesi do të lodhet të kuptojë gjuhën e paraardhësit, prandaj do të fillojë të përdorë mënyrën dhe gjuhën e tij

Zyra e blerjeve



- ka kompiuterin e saj,
- përdor mënyrën e saj për grumbullimin e informacionit (pra ka gjuhën e saj),
- i analizon proceset sipas mënyrës së saj,
- nxjerr raportet sipas mënyrës së saj.

Po nëse edhe kjo figurë largohet?

Magazinjeri



- ka kompiuterin e tij,
- përdor mënyrën e tij për grumbullimin e informacionit,
- i analizon proceset sipas mënyrës të caktuar
- nxjerr raportet sipas një mënyre të caktuar, në varësi të organizimit të kompanisë.

Po nëse edhe kjo figurë largohet?

Tekniku i mirëmbajtjes




- Kryen punët teknike në një mjet,
- evidenton ose jo asetin në të cilin kreu shërbimet sipas gjuhës së tij.
- evidenton ose jo punën e kryer sipas gjuhës së tij,
- evidenton ose jo materialet e përdorura sipas gjuhës së tij

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes

Nëse Ju dispononi një program kompiuterik të menaxhimit të mirëmbajtjes, atëhere gjërat janë komplet ndryshe.

Ato që kanë “shpikur” programin kompiuterik, kanë qenë persona që përpara jush janë ballafaquar me të njëjtat probleme që ju ballafaqoheni sot. Ata kanë bërë një zgjidhje që ju ju jepet e gatshme.


Po çfarë është ndryshe?



Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes

Është e kuptueshme që tashmë për Administratorin është shumë më i thjeshtë kontrolli apo dhe nxjerrja e raporteve të nevojshme. Kjo sepse të gjithë figurat profesionale flasin një gjuhë dhe informacioni është i grumbulluar vetëm në një vend.

Nga ana tjetër, edhe nëse një figurë profesionale largohet, përsëri i gjithë aktiviteti i tij është thjeshtësisht i lexueshëm. Pasardhësi nuk do t'a ketë të vështirë të vazhdojë punën pasi nuk i duhet të fillojë çdo gjë nga fillimi sipas mënyrës së vet.



Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes

Sot ne jemi në gjendje të vlerësojmë performancën e këtij sistemi menaxhimi ndaj dhe e përmirësojmë atë vazhdimisht nën asistencën e një kompanie Gjermane dhe një kompanie vendase.

Ky program kompiuterik është tashmë në gjuhën shqipe dhe është konfiguruar për proceset e mirëmbajtjes pikërisht nga ne të EMC

Aktualisht asnjë aktivitet i kompanisë nuk bëhet jashtë këtij sistemi ndaj dhe ne kemi kontroll të plotë mbi kostot.

Gjithashtu ne kemi harxhuar orë e orë të tëra për t'a implementuar këtë program, për t'a eksploruar dhe për t'ja mësuar personave që e përdorin.

Kemi materiale të shumta në gjuhën shqipe për trajnimin e figurave profesionale në lidhje me përdorimin e këtij programi.

Pra mendojme se jemi të gatshëm.

Duam të krijojmë një dimension të ri komunikimi me kompaninë Tuaj ndaj dhe shprehim disponibilitet maksimal

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes

Por çfarë duhet të dini para se të mrekulloheni?

Duhet të dini që programi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes i heq disa SHKALLE LIRIE si administratorit ashtu edhe të gjitha figurave profesionale që veprojnë në një kompani (veprimet janë të detyrueshme dhe të gjurmueshme).

Çfarë do të thotë kjo?

Kjo do të thotë që nuk mund të kryeni dot procedura të parregjistruara (te ashtuquajtua të zeza).

Por kjo do të thotë që nga ana tjetër të keni një kontroll absolut mbi kostot.


Ndaj para se të vendosni për implementimin e një sistemi të tillë duhet të mendoheni mirë.

Një sistem i tillë sjell një përmbysje të madhe të të gjitha procedurave që keni ndjekur sipas mënyrës tuaj.

NESE NUK DO TI RREZISTONI DOT RREGULLIT DHE DO T'JU DUHET TA SHMANGNI PER NJE ÇAST SISTEMIN KOMPIUTERIK, ATËHERË VETË SISTEMI DO T'JU KOMPLIKOJË VEPRIMTARINË.

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes

Le të shpjegojmë në terma të përgjishme se çfare është dhe si funksionon sistemi i menaxhimit të mirëmbajtjes MAINSAVER




Ky software instalohet në një server me të cilin janë të lidhur të gjithë kompiuterat e figurave profesionale që marrin pjesë në procesin e mirëmbajtjes.

Programi është i përbërë nga MODULE të cilat janë edhe “hapësirat” e punës për:


- Administratorin,
- Përgjegjës të mirëmbajtjes,
- Zyrën e blerjeve,
- Magazinerin,
- Zyrën e burimeve njerëzore

Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes (MAINSAYER)



MAINSAYER menaxhon:

- Blerjet e materialeve dhe shërbimeve
- Magazinat e materialeve
- Punët
- Personelin
- Planifikimin e mirëmbajtjes preventive
- Krijon raporte për menaxhimin




Sistemi kompiuterik i menaxhimit të mirëmbajtjes (MAINSAYER)

Kjo do të thotë që:


- Zyra e prokurimeve do të punojë me modulën “BLERJE”
- Magazinjeret do të punojnë me modulën “MATERIALE”
- Përgjegjësit dhe teknikët e mirëmbajtjes do të punojnë me modulën “MIREMBAJTJE”
- Zyra e burimeve njerëzore do të punojë me modulën “PERSONEL”

Pra çdo figurë profesionale e kompanisë punon në modulën e vet ndërsa e gjithë puna kryhet në një program.



Zakonisht kompanitë e mëdha i kanë të përqëndruar blerjet në qendër edhe pse kantieret e punës janë të vendosura gjeografikisht në vende të tjera. Kjo për faktin e kontrollit të kostove.

Ka gjithmonë një mos-dakordësi midis kantierëve të punës dhe zyrave të blerjeve. Kjo për shumë arsye teknike, në shumicën e rasteve si rezultat i pjesmarrjes së shumë figurave në këtë proces dhe gjuhës jo-standarte të komunikimit.



Kur e kërkoi kantieri pjesën e këmbimit?
Kur i mbërriti në magazinë pjesa e këmbimit?
Kush e ka përgjegjësinë për vonesën?
Kush e ka përgjegjësinë nëse pjesa e këmbimit është blerë gabim?

Nuk janë të pakta rastet kur si rezultat i komunikimeve midis kantierëve dhe zyrave të blerjeve, produktet e blera janë të papërshtatshme. Në këto raste, të dy palët që janë përgjegjës para Administratorit do të mundohen t'ja lënë përgjegjësinë njëra-tjetrës.

Mainsaver i ka zgjidhur të gjitha këto probleme.

KERKESEN E BLERJES e bën kantieri ndërsa URDHRIN E BLERJES e bën zyra e blerjeve

Eshtë e rëndësishme të kuptohet që në një sistem të tillë, emërtimi i materialeve apo dhe i shërbimeve që nevojiten rregjistrohen vetëm një herë (aty ku lind kërkesa) dhe më tej të gjitha procedurat e tjera (blerja, magazinimi, përdorimi) kryhen vetëm me pak klikime.

Eshtë e paimagjinueshme se çfarë rregulli sjell përdorimi i një programi të tillë në kompani.

Mbi të gjitha TE GJITHE FIGURAT PROFESIONALE E DINE QE JANE TE GJURMUAR NE ÇDO VEPRIM TE TYRE, ndaj dhe bëhen më të vëmendshëm dhe më të përgjegjshëm.

Ne jemi të bindur që ju do t'a prekni ndryshimin me dorë.

Dosje Modifiko Modulet Pamje Listat Raporte Kerkese Opsione Dritare Ndhime

Dalje PritSetup Kerko Kalendar Rpt Shkrue... Menuja Kry... Urdher Bler Kerk Bler Kontratet Furnizuesit:

Mb Moduln E Re ShkrimiShp... Klazifiko Rikariko Gjendja Mi...

m Kerkese Blerje - e RE

Kerkese Blerje Detaj Shenime Referenca

Nr.Kerk.Blerjes:

Data Kerk.Blerjes: 30/09/2019 12:55

Data Kerkeses: 30/09/2019

Kerkuar nga: Eduard Ndreu

Regjistruar nga: Eduard Ndreu

Statusi: RQ

Q.K.Ngarkohet: HANSA FLEX

Llog.Ngarkohet: LLOGMAT

Q.K.Kreditohet:

Llog.që Kreditohet:

Departamenti:

Furnit.Rekomanduar: DE170352164

ID Projektit: EMC ASET

Të dhënat mbi kërkesën e blerjes

Çfarë kërkohet për t'u blerë

Dosje Modifiko Modulet Pamje Listat Raporte Kerkese Opsione Dritare Ndhime

Dalje PritSetup Kerko Kalendar Rpt Shkrue... Menuja Kry... Urdher Bler Kerk Bler Kontratet Furnizuesit:

Mb Moduln E Re ShkrimiShp... Klazifiko Rikariko Gjendja Mi...

m Kerkese Blerje - e RE

Kerkese Blerje Detaj Shenime Referenca

Nr Kerk Blerie **Giendja:** RQ

Perzgjires Kerk	Numri Stokut	Pershkrimi	Total	Sasia Porositur	Kompania	Kategoria Artikullit	Shoqeria e Rekomanduar	Njësia Matëse
☐	108BS011	Guarnicion me rondele 16.51x25.4x2.1 NBR	\$0.00	.0000	Hansa Flex	GDS	Hansa Flex	COPE
☐	2 BEPCO 21/42-37PK	Valvol thithje (DEUTZ F3L913G)	\$0.00	.0000	TASE AGRO	GDS	TASE AGRO	COPE
☐	3 FANTUZZI B30_010_065	Valvol Solenoid Proporcionale GRCY037N54	\$0.00	.0000	MHPS ITALIA SRL	GDS	MHPS ITALIA SRL	COPE
☐	4 ASKAYNAK 40450	Elektroda Saldimi Çeliku Ø4.0 x 450 mm (6-75)	\$0.00	.0000	Ruslan Rusht Bebo	GDS	Ruslan Rusht Bebo	KG
☒	5 CASTROL 456617/8	HYSPIN AWS-46 (Vaj Hidraulik)	\$0.00	.0000	B&A- 02 sh.a	GDS	B&A- 02 sh.a	LT
			\$0.00					

EMC disponon materiale të shkruara për të trajnuar punonjësit për plotësimin korrekt të çdo hapësire të skedave dhe të moduleve që i përkasin procedurës së BLERJEVE

Pra përveç eksperiencës që kemi krijuar në përdorimin e përdidshëm të këtij programi, ne kemi shkruar edhe gjithë “Help-in” e programit, në gjuhën shqipe.

Vetëm nga rregulli që një program i tillë vendos, kompania ka përfitime materiale të konsiderueshme.

Janë bërë studime të detajuara për të krahasuar kompanitë që përdorin programe të tilla me kompanitë që nuk i përdorin.

Konkluzioni është që investimi në një program të tillë menaxhimi është që investimi i një programi të tillë është aq sa kompania kursen në 3 javë thjeshtë nga përdorimi i tij.

Nga kontaktet me pronarë të kompanive që disponojnë një numër të konsiderueshëm asetesh për t'u mirëmbajtur, kemi hasur në skepticizmin e tyre.


Nuk besoj se ata dëshirojnë të harxhojnë para më shumë seç duhet.

Besoj se ata nuk kanë shumë informacion mbi përfitimet që kanë nga përdorimi i këtyre programeve.

Përfundimisht për BLERJET, Administratori i Kompanisë jep vetëm një urdhër të prerë:

NUK DO TE BEHET ASNJE PAGESE QE NUK SHOQEROHET ME NJE URDHER BLERJE

Pas këtij urdhri, të administratorit të tjerat i zgjidh sistemi



Pas hyrjes së materialeve në magazinë, zyra e blerjeve ka përfunduar aktivitetin e saj.

Tani fillon menaxhimi i magazinës

Menaxhimi i magazinës bëhet nga një figurë tjetër profesionale. Veprimet e tij janë të gjitha sipas një itinerari të përcaktuar.

Magazinimi është një proces që kalon në hapat e mëposhtëm

Hyrje të materialeve në magazinë

Sistemimi i materialeve në magazinë

Dalje e materialeve nga magazina

Dosje Modifiko Modulet Opsione Dritare Ndihme
 Dalje PrintSetup Kurko Kalendar Rpt Shkruar... Monja Kry... Matri Pjesore Transakcio Pajth Mti Furnizuesit Detaje Niv... Kufidorur
 Mb Modulin Dalje Dalje e KV Marr Rikthej Transfirim Pajth Furnizuesit Censor Gjendje e N... UP i Ri

Marrje e Transaksionit
 Burim: UB Data e kuit.: 30/09/2019 Magazine: Zona:
 ID e Punonj: Nr.U.Blerjes: Tipi UB:
 Nr.Flete Pkt:
 NIPT-i:

Dosje Modifiko Modulet Pamje Listat Raporte Kerkese Opsione Dritare Ndihme
 Dalje PrintSetup Kurko Kalendar Rpt Shkruar... Monja Kry... Matri Pjesore Transakcio Pajth Mti Furnizuesit Detaje Niv... Kufidorur
 Mb Modulin E Re ShkrimiShp... Gjendje e N... Kufidori Rikariko

Master Pjesore - Shkruaj - [AOVRNW10LED]
 Stok Detaj Vendndodhja Pika Urdherit Furnizuesi Financiare Ku Perdorur Perdorues i Percaktuar
 Numri Stokut: AOVNRW10LED Pershkrimi: Rakord-konektor M/S AGR3/8"-WD DKOL12
 Nr. Pjes.Kembimit: AOVNRW10LED
 Cmimi i Shites: \$482.38 Non Stock Flag:
 Totali Gjendje: 4.0000 Rregulli Urdherit: T
 NLM Dalje: COPE Gendri.Kostos: HANSA FLEX
 Kodi Artikullit: AOVRED Llogaria:
 Vendndodhja: MG2EMCS-D-1 Furnit.Rekomand DE170352164
 Magazina: MG2 Zona EMC HANSA-FLEX AG
 ID e Rafitit: S-D-1 Prodhues: HANSA-FLEX AG
 Sasia Gjendje: 4.0000 Nr.Pjeses (Prodh):

Dalje PrintSetup Kurko Kalendar Rpt Shkruar... Monja Kry... Matri Pjesore Transakcio Pajth Mti Furnizuesit Detaje Niv... Kufidorur
 Mb Modulin Dalje Dalje e KV Marr Rikthej Transfirim Pajth Furnizuesit Censor Gjendje e N... UP i Ri

Transaksioni - Dalje
 Magazine: Zona: Date e Daljes: 30/09/2019
 ID Punonjesit Nr.Kerk.Mat: Nr.Urdh.Punës Nr.Asetit Q.K.Ngarkohet Llog.Ngarkohet
 Numri Stokut Nr. Pjes.Kembimit Pershkrimi Vendndodh.Stoku Sasia Gjendje Totali Dispon. Dalja e Nj.M Sasia Materialit
 0.0000 .0000 .0000

Sa më shumë materiale disponon në magazinë, aq më shumë e ndjen nevojën e menaxhimit të saj nga një program i tillë.

Të gjitha veprimet e kryera me një material të caktuar janë të evidentuara tek moduli i MATERIALEVE

Magazinimi

(Hyrjet në magazinë të materialeve)

Futjet fizikisht të materialeve në magazinë shoqërohen edhe me procedurat administrative të hyrjes.

Dosje Modifiko Modulet Opsione Dritare Ndihme

Dalje PritSetup Kerko Kalendar Rpt Shkrue... Menuja Kry... Matr Pjesere Transakns Perputh Mtl Furnizuesit: Detaje NrY... KuPendorur

Mb Moduln Dalje Dalje e KV Marr Rikthej Transferim Poz Furnizu... Crezerv Gjendja e N... UP i Ri

m Marrje e Transaksionit

Burim: UB Data e kuit.: 30/09/2019 Magazine: Zona:

ID e Punonj.: Nr.U.Blerjes: Tipi UB:

Nr Flete Pkt: NIPT-i:

I gjithë procesi është shumë i thjeshtë sepse lista e materialeve thërret prej Urdhrit të Blerjes. Pra nuk harxhon kohë të rishkruash listën apo ta transferosh atë me e-mail nga zyra e blerjeve tek magazina.

Në këtë mënyrë për çdo material ka një historik të detajuar.

Informacioni që regjistrohet për një material në modulën e magazinës është shumë i madh.

Falë këtij fakti mund të behet analizë e thelluar në çdo rast.

Magazinimi (Sistemimi në Magazinë)

Magazina konfigurohet me adresa. Materialet sistemohen në raftin që ka një adresë të caktuar. Gjetja e materialeve është shumë e shpejtë.

Dosje Modifiko Modulet Pamje Listat Raporte Kerkese Opsione Dritare Ndhme

Dalje PritSetup Kerko Kalendar Rpt Shkru... Menuja Kry... Mstr Pjesve Transakc Perputh Mtl Furnizuesit Detaje NrV... KuPerdorur

Mb Moduln E Re ShkrimiShp... Gjendje e N... Klacifiko Rikarikoj

m Master Pjesve - Shkruaj - [XEWOM45NW32HS]

Stok Detaj Vendndodhja Pika Urdherit Furnizuesi Financiare Ku Perdorur Perdorues i Percaktu

Numri Stokut: XEWOM45NW32HS **Pershkrimi:** Rakord-Konektor 45° AGM48x2-OR CES38

Nr. Pjes.Kembimit: XEWOM45NW32HS


Cmimi i Shitjes: \$9,097.22	Non Stock Flag: ☐
Totali Gjendje: 1.0000	Rregulli Urdhërit: T
Nj.M Dalje: COPE	Qendr.Kostos: HANSA FLEX
Kodi Artikullit: XEWOM45	Llogaria:
Vendndodhja: MG2EMC4-A-6	Furnit.Rekomand: DE170352164
Magazina: MG2 Zona: EMC	Prodhuës: HANSA-FLEX AG
ID e Raftit: 4-A-6	Nr.Pjesës (Prodh
Sasia Gjendje: 1.0000	



Në kompiuter tregohet që “Rakord-Konektor 45° AGM48x2-OR CES38” gjendet në magazinë në Rreshtin 4, kollona A, kati 6. Pra reduktohet maksimalisht koha për të gjetur një material si dhe është shumë e thjeshtë të bësh inventar në çdo moment.

Magazinimi (Daljet nga Magazina)

Daljet nga magazina bëhen nëpërmjet një skede të veçantë. Nëpërmjet këtij procesi, çdo dalje evidentohet në kohë reale dhe ka një destinacion të njohur. Kjo për faktin se daljet i përkasin një Urdhri pune i cili është për një aset të caktuar.



ID Punonjësit	Nr.Kërk.Mat.	Nr.Urdh.Punës	Nr.Asetit	Q.K.Ngarkohet	Llog.Ngarkohet

Numri Stokut	Nr. Pjes.Këmbimit	Pershkrimi	Vendndodh.Stoku	Sasia Gjendje	Totali Dispon.	Dalja e Sas	Nj.M Materialit	Spe
				0.0000	.0000	.0000		

Informacioni që regjistrohet për çdo material është i shumtë. Këtu mund të shihet se në cilin aset është përdorur materiali apo dhe në cilët asete të tjera mund të përdoret ky material.

Shpjegimet që po bëjmë janë të formës së përgjithshme sepse sistemi kompiuterin MAINSAVER ofron opsione të jashtëzakonshme për të organizuar procesin sipas interesit tuaj.

MIREMBAJTJA (Rregjistrimi i aseteve)

Mirëmbajtja është një modul ku menaxhohen punët.

Llogjika për kryerjen e punëve bazohet duke i adresuar ato tek një aset i caktuar. Prandaj para së gjithash në programin kompiuterik duhet të rregjistrohen asetet një e nga një. Për më tepër kur aset i përbëhet nga disa njësi, atëherë rregjistrohen njësitë veç e veç dhe i bashkëngjiten asetit kryesor.

Dosje Modifiko Modulet Pamje Listat Raporte Kerkese Opsione Dritare Ndhime

Dalje PritSetup Kerko Kalendar Rpt Shkrue... Menuja Kry... Objekte Kerk Mtl Kerk Pune Urdher Pune Buxhet Furnizuesit: C

Mb Modulin E Re ShkrimiShp... Klasifiko Rikarikoj Referenca Lista Kombi... Perditeso ... Gjendja Zevend Nje...

m Objekt - Shkruaj - [EMCM002 - Forklift LINDE E25-02 (336-02)]

Objekti Detaj Financiare PM Besueshmeria Pj. Kemb Perdorues i Percaktuar Referen

Nr.Asetit: EMCM002

Tipi Asetit: Makineri

Statusi Asetit: PUN

Zona Punës: EMCQND

Faktori Kritik: N

Qendr.Kostos: QERATE EMC

Customer Numbe:

Vendndodh.Asetit: Oficina qendrore

Pershkrim Shkurtër: Forklift LINDE E25-02 (336-02)

Pershkrimi Zgjerruar: Mjet per perpunimin e ngarkesave

ID Përhershme: LINDE E25-02 (336-02)

Nr.Asetit Prind:

Kodi Grupit Aseteve:

Caktuar tek:

Kalibrim?: ☐ **Kodi Asetit:**

Kërkesat Sigurisë: Te zbatohen rregullat e sigurise ne pune gjate kryerjes se procedurave te mirembajtjes

Çdo aset i vendoset një numër si dhe i rregjistrohen të dhënat sipas fushave të programit.

Për çdo aset ju keni mundësi të rregjistroni orët e punës në mënyrë progresive. Programi ka llogjikën e paralajmërimit për shërbimet periodike që duhet të kryhen.

Për çdo punë të kryer mbi aset krijohet një historik i detajuar.


Në këtë mënyrë ju keni mundësi të mëdha për të bërë analizat e duhura për çdo aset.

MIREMBAJTJA (Kërkesa e Punës)

Mirëmbajtja është një modul ku menaxhohen punët.

Mjaft që Administratori i kompanisë të urdhërojë që asnjë punë nuk do të kryhet pa patur një URDHER PUNE, dhe çdo gjë futet në shinat e mirëadministrimit.

Le të stimulojmë një rast kur në njëri prej kantierëve të një kompanie kërkon riparimin e një asemi nga Sektori i Mirëmbajtjes.



Kërkesë Pune - E Re

Nr.Kërkes.Punës:	30	Login ID:	msadmin
Krijuesi:	msadmin	Data Krijimit:	30/09/2019 13:50
Nr.Tel:		Data Kryerjes:	30/09/2019 13:50
Nr.Asetit:			
Nr.Asetit Prind:			
<u>Punë e Kërkuar:</u>			
<u>Q.K.Ngarkohet:</u>			
Prioriteti Krijimit:	3	Siguri në	☐
Statusi:	GB	Tipi Punës:	
Nr.Urdh.Punës:		Klasifik.Punës:	
Miratues:		Grupi Punës:	
Data Miratimit:	00/00/0000	Data Refuzimit:	00/00/0000 00:00
ID Projektit:		Arsyeja Refuzimit:	
		Planifikuesi:	

Shërbimi i riparimit kërkohet duke plotësuar një Kërkesë Pune në skedën përkatëse, në Modulën "Mirëmbajtje" të programit Mainsaver. Kantieri mund të jetë në Kukës ndërkohë që Sektori i Mirëmbajtjes është në Tiranë.

Siç shihet në figurën majtas, aty evidentohen data dhe ora e plotësimit të kërkesës, asemi mbi të cilin duhet të kryhet shërbimi, puna që kërkohet, etj.

Kërkesa e punës MIRATOHET nga personi i autorizuar.

Pasi kërkesa është miratuar, Sektorit të Mirëmbajtjes Hap Urdhrin e punës, ku planifikohen punonjësit dhe materialet që duhen.

MIREMBAJTJA (Urdhri i Punës)

Si rregull një Teknik i Lartë është personi që planifikon veprimet që duhet të kryhen dhe materialet (pjesët e këmbimit) që nevojiten për të eliminuar defektin. Prandaj ai është edhe figura profesionale që Hap Urdhrin e punës. Urdhri i Punës, është në vetvete edhe një preventiv i kostove financiare.

Nga ana tjetër Urdhri i punës mund të përpilohet edhe si një guidë e të gjithë aktiviteteve që duhet të kryejnë teknikët zbatues (pra Inxhinjeri përcakton aktivitetet që duhen kryer, teknikët zbatojnë punët e kryera).



Dosje Modifiko Modulet Pamje Listat Raporte Kërkesë Opsione Dritare Ndhime

Dalje PritSetup Kërko Kalendar Rpt Shkru... Menaja Kry... Objekte Kerk Mtl Kerk Pune Urdher Pune Bashet Furnizuesit: C

Mb Moduln E Rc ShkrimiShp... UP Cmpl Mbyll UP Klasifiko Rikarikoj Hap UPt Lista Kombi... Gjendja Para Sked

Urdher Pune-I Ri

Urdher Pune Detaj Financiare Veprimi Perdorues i Percaktuar Referenca

Mr.Urdh.Punës:

Krijuesi: Eduard Ndreu ID Projektit: EMC

Nr.Tel: +355 692044644 Data Krijimit: 30/09/2019 16:04

Nr.Slotit: Q.K.Ngarkohet: QERATE EMC

Nr.Asetit: EMC006 Zona Punës: EMCQND

Forklift LINDE E25-03 (336-03) Vendndodh.Asetit: Oficina qendrore

Customer Number: A0001

Kodi Grupit Aseteve: Kodi Defektit: Statusi Asetit: PUN

Punë e Kërkuar: Nuk ka force per ngritjen e ngarkesave. Te identifikohet dhe te eliminohet defekti

Statusi: GB Prioriteti Krijimit: 3

Data Kryerjes: 30/09/2019 16:04 Prioriteti: 3

Statusi i Urdhrit të Punës është ai që evidenton faktet se në çfarë hapash ka kaluar procesi i riparimit përsa i përket procedurave.


Bazuar në veprimet që kryhen me Urdhrin e Punës, krijohet një historik për çdo nderhyrje që ka kryer sektori i mirëmbajtjes.

- Çfarë pune është kryer,
- Kush e ka kryer,
- Kur e ka kryer,
- Çfarë materialesh janë përdorur,
- Sa janë kostot e shërbimit, etj

MIREMBAJTJA (Kerkesa për Materiale)

Pasi është hapur Urdhri i punës dhe janë caktuar punonjësit, i bëhet kërkesë magazinës për materialet që nevojiten.

Magazina përgatit materialet e kërkuara dhe ia bën dalje punonjësit të përcaktuar në Urdhrin e Punës

Kerkesa e Materialit - E Re

Krye

Nr.Kerk.Mat.: Data Krijimit:

Data Kerkeses:

Kerkuesi: Gendr.Kostos:

Nr.Urdh.Punes: Llogaria Materialeve:

Nr.Asetit:

Permbledhje e Vjes se Njesise

Vendndodh.Stokut	Sasia	Kerkuar	Kos
<u>Pershkrimi</u>	<u>Ni.M</u>	<u>Materialit</u>	

Mund t'ju duken shumë procedura të gjata por kjo nuk është aspak e vërtetë.

Veprimet që kryhen me letra ose në kompiuter nëpërmjet tabelave EXEL, do të zëvendësohen nga veprimet në programin kompiuterik.

Performanca është e garantuar

Besoj se është e kuptueshme që për të ndjekur praktika të tilla në punë, duhet që punonjësit të veprojnë të koordinuar, si pjestarët e një orkestre.

Që punonjësit të kryejnë veprime të koordinuara duhet të stërviten, pra duhet të trajnohen.

Kompania nuk është gjë tjetër veçse kompetenca profesionale e punonjësve e menaxhuar në mënyrën e duhur.

Nuk ka rëndësi se çfarë pune bën kompania.

Po pati punonjës kompetent që menaxhohen në mënyrën e duhur, rezultati është i garantuar.

Hyni në internet dhe shikoni një website të një kompanie të ngjashme me ju. Do të gjeni padiskutim aty rekomandimin për të trajnuar punonjësit vazhdimisht.

Sa herë që jeni të pakënaqur nga një punonjës për paaftësinë e tij, pyesni veten **PSE DUHET TE DIJE? KUSH E KA MESUAR?**

Ndaj suksesi i punës tuaj ka të bëj me **TRAJNIMIN** e punonjësve.

Ne në EMC i kemi besuar këtij rekomandimi, ndaj po punojmë intesivisht për të krijuar programe të detajuara trajnimi për punonjësit.

Shihni më tej.

Ashtu si edhe Ju ne nuk jemi të kënaqur nga performanca e punonjësve dhe për komoditet e transferojmë “fajin” tek ata. Në fakt kjo nuk është shumë e ndershme.

Tekniku cilësohet kompetent kur garanton tre cilësi kryesore:


1. Ka njohuri të thella TEORIKE mbi profesionin e tij,
2. Ka eksperiencë dhe ka njohuri të thella PRAKTIKE mbi profesionin e tij,
1. Di të komunikojë.

Cituar nga “Manuali i Mirëmbajtjes Industriale”

Po cila shkollë në vendin tonë është aq specifike sa t’i mësoj në detaj për çdo fushë veprimtarie?

Gjithë bizneset e suksesshme ia dedikojnë suksesin e vet TRAJNIMIT TE VAZHDUESHEM të punonjësve.

Prandaj dhe ne kemi përgatitur programe trajnimi të detajuara për:



Sigurinë në Punë

Menaxhimin e Mirëmbajtjes

**Teknikët e Lartë të
sistemeve elektro-
hidraulike**

**Teknikët e Mesëm të
sistemeve elektro-
hidraulike**

Programi i Trajnimit (Siguria në Punë)

Asgjë nuk është më e rëndësishme se siguria në punë. Puna në mjetet industriale ka rrezik të shtuar, ndaj edhe vemendja ndaj zbatimit të rregullave të sigurisë duhet të jetë e shtuar.

Që rregullat e Sigurisë në Punë të zbatohen, fillimisht duhet që ato të njihen.

Ndaj EMC shpk i ka kushtuar rëndësi të veçantë trajnimit të punonjësve për rregullat e sigurisë në punë.

Ato ndahen në dy grupe të mëdha

Rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë

Gjatë kryerjes së
punëve në sistemet
hidraulike

Gjatë kryerjes së
punëve në lartësi

Gjatë kryerjes së
punëve në për
riparimin e gomave

Gjatë kryerjes së
punëve mekanike

Saldimet

Etj.

Rregullat specifike të sigurisë në punë

Gjatë kryerjes së
mirëmbajtjes në Mjetet
LINDE

Gjatë kryerjes së
mirëmbajtjes në Mjetet
CATERPILLAR


Etj.

Skeda trajnuese disponohen aktualisht për trajnimin e sigurisë në punë

	SKEDA E TRAJNIMIT Mbi sigurinë në Punë	SKEDA EMC-SP15
Tema: DENTIMI NGA PRESIONI I LARTË I VAJIT		Oficina në Port
PROGRAMI I TRAJNIMIT		
A. TE PERGJITHSHME B. DENTIMET NGA PRESIONI I LARTË I VAJIT C. AKUMULATORET HIDRAULIK D. PARANDALIMI I DENTIMEVE NGA PRESIONI I LARTË I VAJIT E. SHEMBUJ		
ZHVILLIMI I PROGRAMIT		
A. TE PERGJITHSHME		
Dëmtimet që mund të pësohen nga forcat që linden nga presioni i lartë i vajit hidraulik, përbëjnë një rrezik potencial për jetën ose shëndetin e punonjësve apo personave të tjerë që mund të gjenden aty pranë. Është praktikisht e pamundur të parashikohen të gjitha rastet e mundshme të ndodhjes së aksidenteve në punë si rezultat i forcave që linden nga presioni i lartë i vajit hidraulik. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që punonjësit të njohin rrezikshmërinë që lind në këtë rast për jetën ose shëndetin e tyre dhe në të njëjtën kohë është shumë e rëndësishme që të njihen dhe të zbatohen në mënyrë rigoroz rregullat e sigurisë në punë. Mos u nixtoni kurrë për kryerjen sa më parë të një procesi pune pavarësisht presionit që mund të keni në lidhje me afatin e kryerjes së punës. Siguria është e para. Asnjë proces nuk ka rëndësi përpara garantimit të jetës dhe shëndetit. Respektimi i rregullave të sigurisë në punë parandalon maksimalisht ndodhjen e aksidenteve në punë dhe për pasojë parandalon rrezikimin e jetës ose të shëndetit të punonjësve.		
B. DENTIMET NGA PRESIONI I LARTË I VAJIT		
Në sistemet hidro-mekanike për mposhtjen e forcave shfrytëzohet presioni i vajit hidraulik. Në sisteme të ndryshme ekzistojnë presione të ndryshme, të llogaritura nga prodhuesi i makinerisë ose pajisjes. Në sistemet hidraulike, presioni i vajit kontrollohet me anë të valvolave të cilët janë komponentë që mund të pësojnë dëmtime të ndryshme dhe për pasojë dhe të mos realizojnë qëllimin për të cilin janë ndërtuar. Si rezultat i këtyre presioneve të larta linden forca të mëdha të cilat nëse janë të pakontrolluara mund të sjellin dëmtime të shumta në sistem dhe për pasojë dhe në jetën ose shëndetin e punonjësve që mund të ndodhen aty pranë. Presioni i mbetur në sistem edhe pas fikjes së makinerisë është një element që duhet mbajtur gjithmonë në konsideratë, pasi ai mund të bëhet shkak i lëvizjes së pakontrolluar të komponentëve të tjerë të makinerisë ose pajisjes. Gjatë zmontimit të komponentëve hidraulik, në një sistem ku ekziston presioni i mbetur, si rezultat i shfryrjes së presionit në mënyrë të menjëhershme, mund të linden forca të mëdha të rakordrive ose copëzave të tyre, të komponentëve të tjerë hidraulik ose të copëzave të tyre, të cilat mund të dëmtojnë në mënyrë serioze shëndetin e punonjësve ose të personave të tjerë që mund të gjenden aty pranë. Akumulatorët hidraulik, që ndryshe mund të quhen edhe "magazina të vajit me presion" mund të përbëjnë një rrezik serioz për punonjësit që kryejnë shërbimet e mirëmbajtjes së tyre dhe për punonjësit që mund të gjenden aty pranë. Vetë vaji hidraulik është një komponent që kategorizohet tek mallrat e rrezikshme, bazuar në përbërjen kimike të elementëve të tij. Ndotja e syve, organeve të frymëmarrjes, etj nga vaji hidraulik mund të përbëjnë një dëmtim serioz të shëndetit të punonjësve.		
C. AKUMULATORET HIDRAULIK		

Akumulatorët hidraulik, janë "magazina të vajit me presion". Si të tillë ata në vetvetë përbëjnë një rrezik të shtuar të cilin punonjësit e kompanisë EMC shpesh duhet ta mbajnë gjithmonë në konsideratë.

KINI FRIKE NGA AKUMULATORET HIDRAULIK. Ky është hapi i parë i respektimit të rregullave të sigurisë.



D. PARANDALIMI I DENTIMEVE NGA PRESIONI I LARTË I VAJIT

Në manualat e mirëmbajtjes dhe riparimit të makinerive të ndryshme rekomandohen rregullat për kryerjen në mënyrë të sigurtë të proceseve të caktuara. Këto rregulla rekomandohen duke u bazuar në parashikimin më të madh të mundshëm të rrezeve që mund të kryhen gjatë atij procesi. Punonjësit e EMC shpesh ballafaqohen me shumë raste kur manualat teknike të mirëmbajtjes dhe riparimit nuk ekzistojnë. Për këtë arsye, në analogji me rekomandimet që jepen për makineritë ose pajisjet që disponojnë sisteme hidraulik, do të shtellojmë më poshtë disa nga rregullat e sigurisë për të minimizuar, mundësisht eliminuar rrezikun që lind nga presioni i lartë i vajit hidraulik.

Prandaj rekomandohet që:

- makineria ose pajisja të jetë e pastruar mirë, nga jashtë, para se të pozicionohet në vendin e caktuar për kryerjen e punës,
- makineria ose pajisja të pozicionohet në një ambient të pastër dhe të ndriçuar,
- pozicionimi i makinerisë të bëhet në mënyrë të atillë që të mos pengojë lëvizjen e lirshme, rreth e qark tij, të punonjësve,
- në shërbimet e mirëmbajtjes të marrë pjesë vetëm personel i kualifikuar dhe i autorizuar për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes,
- të largohen nga makineria ose pajisja të gjithë personat e tjerë që nuk kanë lidhje me kryerjen e punës,
- të sigurohet parkimi i makinerisë ose pajisjes me frenat e parkimit të mjetit ose me mjete të tjera nëse ato janë të defektuara ose nuk ekzistojnë,
- të njihet funksionimi i makinerisë,
- të njihet funksionimi dhe ndërtimi i sistemit hidraulik të makinerisë,
- të njihet funksionimi dhe ndërtimi i komponentit hidraulik mbi të cilin po kryhen shërbimet e mirëmbajtjes,
- të përdoren pajisjet mbrojtëse të punonjësve,



- të fiket motori i makinerisë ose pajisjes,
- të mos lejohet të qëndrojnë njeri në postin e komandës së makinerisë ose pajisjes,
- të vendoset një shënim "Mos e ndiz, mjet në shërbim mirëmbajtje" në panelin e kontrollit të makinerisë ose pajisjes,
- të kryhen procedurat paraprake për shfryrjen e presionit:
 - të hapet kapaku i depozitës së vajit hidraulik,
- të ndizet kuadri i makinerisë (pa ndezur motorin) dhe të lëvizet disa herë levat e komandimit, në të gjitha pozicionet,

Programi i Trajnimit (Menaxhimi i Mirëmbajtjes)

Në asnjë shkollë të vendit nuk ekziston lënda e Menaxhimit të Mirëmbajtjes.

Përgjithësisht kompanitë punësojnë Inxhinjerë mekanik ose dhe Inxhinjerë të tjerë të cilët nuk kanë asnjë njohuri specifike për menaxhimin e mirëmbajtjes.

Sado i përkushtuar të jetë një person për kryerjen e punës, përsëri nuk mund të arrij rezultat konkret nëse nuk ka njohuritë e duhura.

Jo vetëm përgjegjësit e mirëmbajtjes por edhe teknikët e lartë duhet të kenë njohuri me menaxhimin e mirëmbajtjes. Kjo pasi detyrat nuk mund të ndahen me thikë. Përgjithësisht veprimet në punë janë të integruara.

Për këtë arsye ne kemi krijuar programe trajnimi për përgjegjësit dhe për teknikët tonë.


Këto programe janë të vlefshme edhe për të gjithë punonjësit e kompanive që duan të krijojnë një mardhënie partneriteti me EMC shpk.

EMC shpk është projektuar dhe po punon për të qenë një kompani lider në Shqipëri në fushën e mirëmbajtjes së makinerive të punës.

Eshtë kjo arsyeja përse ne po tentojmë të krijojmë një rrjet bashkëpunëtorësh dhe partnerësh.

Programi i Trajnimit (Menaxhimi i Mirëmbajtjes)

Skeda trajnuese disponohen aktualisht për trajnimin e mbi menaxhimin kompiuterik të mirëmbajtjes,



Pas klikimit tek moduli “MIREMBAJTJE”, kliko tek ikona “Urdher Pune” – shfaqet pamja e mësipërme.

Ikonat e vendosura në rreshtin e dytë, janë instrumentat e punës për të hapur, modifikuar, kompletuar, mbyllur urdhrat e punës.


Hapja(përgatitja) e një Urdhri Pune, presupozon planifikimin si dhe përgatitjen e preventivit për një punë të caktuar.

Modifikimi i Urdhrit të Punës, presupozon mundësinë për të ndryshuar të dhëna që lidhen me profesionet, kohën e punës, numrin e punonjësve, materialet, aktivitetet që janë planifikuar më parë për kryerjen e një pune të caktuar.

Kompletimi i Urdhrit të punës është një procedurë që kryhet nga personi i autorizuar i EMC, në përfundim të punës së kryer, para se procesi të konfirmohet nga personi i autorizuar i KLIENTIT.

Mbyllja e Urdhrit të Punës, është procedura që kryhet nga personi i autorizuar i EMC, pasi puna e planifikuar është kryer si dhe pasi të dhënat e regjistruara në lidhje me kohën e punës (orët e shpenzuara për kryerjen e punës së planifikuar) dhe të dhënat e regjistruara për materialet e përdorura për kryerjen e punës, janë konfirmuar nga personi i autorizuar nga KLIENTI.

Kujdes! Kur një urdher pune mbyllet, të dhënat e tij nuk mund të modifikohen.



Pasi klikon mbi ikonën “ERE”, shfaqet pamja e mësipërme.

Në këtë skedë:

- Nr. i UP: plotësohet automatikisht nga sistemi, kur përgatitja e Urdhrit të Punës konfirmohet duke klikuar OK.
- Në fushën “KRIJUESI:” dhe në fushën “Telefon”, plotësohen automatikisht nga sistemi të dhënat e personit që është autorizuar nga EMC, si përdorues i sistemit MainSaver;
- Në fushën “NUMRI I OBJEKTIT:”, përzgjidhet ose shkruhet direkt, aseti (objekti) mbi të cilin do të kryhet puna që po planifikohet

Kujdes!

1. Në kuadratet e identifikuara me emërtime me ngjyrë të kuqe, duhet të plotësoni detyrimisht të dhëna, në të kundërt nuk mund të kaloni në fazën tjetër.
2. Në çdo fushë që shoqërohet me simbolin e lups (dijatfas fushës), duke bërë dopio klik mund të përzgjidhni informacione të regjistruara më parë.

Teknikët e mesëm janë figura profesionale shumë të rëndësishme në kompani. Ato përbëjnë edhe numrin më të madh të të punësuar në të gjitha kompanitë.

EMC shpk ka ndjekur me vemendje performancën e teknikëve të mesëm. Me ndihmën edhe të sistemit ne kemi parë që koha efektive e ketyre punonjësve në punë nuk i kalon 3,5 orë në ditë.

Është e kuptueshme se këto shifra janë shumë të ulëta dhe nuk garantojnë sukses në punë.

Një nga elementët kryesor të mosefektivitetit është edhe “xhirot boshe” që bëjnë punonjësit si rezultat i njohurive të ulëta teknike që ato kanë.

Po ju jap një shembull të thjeshtë.

Supozojmë se një rakord hidraulik rrjedh vaj dhe duhet ndërruar.


Nëse një teknik nuk është në gjendje të njohë rakordet hidraulike, atëherë ai do të vij vërdallë duke provuar nëse filetat shkojnë apo jo. Pastaj ka raste që edhe kur filetat shkojnë përsëri rrjedhja e vajit është e pranishme (rakordet M16x1.5 të serisë së lehtë nuk janë të njëjtat me rakordet M16x1.5 të serisë së rëndë).

Atëherë imagjinoni kohën që humbet nga “xhirot boshe”.

Punonjësit duhet të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme.

EMC shpk disponon shumë skeda trajnuese për teknikët e mesëm.

Hyrja dhe qëndrimi i papastërtive në sistemin hidraulik



Teknikët e lartë janë figura profesionale jetësore për një kompani.

Ju e dini që çdo impiant, makineri apo pajisje që prodhohet shoqërohet nga librat teknikë ku tregohet mënyra e ndërtimit, mënyra e funksionimit, skema elektrike, hidraulike, etj.

Këto dokumenta shoqëruese të asetit janë shumë të rëndësishme. Nëse nuk disponohen është shumë e vështirë që ato të disponohen.

Natyrisht që edhe kur i ke librat, ato dikush duhet t'i lexojë.

Ky funksion shumë rrallë merret përsipër të kryhet nga teknikët e mesëm. Ndaj janë teknikët e lartë ata që duhet të dinë të lexojnë dhe të interpretojnë proceset.

Po bëhet gjithnjë e më e vështirë që të gjenden njerëz të përgatitur. Shumica e tyre preferojnë të punojnë në perëndim.

Ndaj ne që kemi vendosur të jetojmë në Shqipëri kemi vetëm një zgjidhje:


TE TRAJNOJME VAZHDIMISHT PUNONJES DUKE SHPRESUAR QE ATA TE MOS IKIN JASHTË.

Natyrisht që sa më shumë ata specializohen aq më shumë mundësi kanë jashtë.

Ky është një rrisht që duhet të marrin të gjithë.

KOMPANITE NUK DUHET TE LODHEN DUKE TRAJNUAR PUNONJESIT NE MENYRE TE VAZHDUAR

EMC shpk disponon skeda të shumta që i përkasin programit të trajnimit për teknikët e lartë të fushës së mirëmbajtjes dhe riparimit të makinerive industriale



Kontrolli 'Load Sensing' i një pompe fikse realizohet duke instaluar në sistem një hidrostat (që funksionon duke u hapur) dhe një valvol lundruese me anë të të cilës presioni që krijohet nga ngarkesa në cilindrin hidraulik, dërgohet si sinjal në dhomën e sustës së hidrostatit. Settingu i sustës së hidrostatit është zakonisht 10 bar.

Si rezultat i kësaj kuptohet që presioni para valvolës drejtuese proporcionale është gjithmonë 10 bar më i madh se presioni pas valvolës proporcionale.

E gjithë prurja tjetër e pompës që nuk përdoret për të mbajtur këtë diferencë presioni prej 10 bar shkon në depozitë. E thënë ndryshe, i gjithë vaji që nuk kërkohet nga cilindri hidraulik për të realizuar punën shkarkon në depozitë nëpërmjet hidrostatit.

Pra nëse presioni i punës është psh 100bar dhe settingu i sustës është psh 10bar, atëherë prurja e tepërt e vajit do të shkarkohet në depozitë kur presioni të arrijë në 110bar. Nga kjo kuptohet që pompa do të ketë efikasitet të ulët sepse një pjesë e prurjes që ajo prodhon nuk kryen punë por shkarkohet në depozitë. Gjithashtu si rezultat i këtij fenomeni, meqë vaji kalon nga një zonë me presion të lartë në depozitë pa kryer punë, krijohet nxehtësi, pra vaji hidraulik nxehet.

EMC shpik e ka qendrën në Rrashbull Durrës, në autostradën Tiranë- Durrës.

